



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8 Qershor 2021

Nr. 385

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kandidatit për deputet z. Dionis Imeraj.

Kërkues 1: Partia Demokratike, dega Dibër

Kërkues 2: Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Ndaj: Kandidatit për deputet z. Dionis Imeraj

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREJ:

I. Vlerësimi paraprak



Data: 8 Qershor 2021
Nr. 385

Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kandidatit për deputet z. Dionis Imeraj.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, më datë 6.4.2021 është raportuar një kallëzim në e-mail info@kqz.gov.al, nga subjekti politik Partia Demokratike, dega Dibër, administruar në KQZ me nr. 3518 prot., datë 9.4.2021, i njëjti kallëzim është raportuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, administruar në KQZ me nr. 4019 prot., datë 20.4.2021, për shkelje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas denoncuesit pretendohet se: *“Kandidati për deputet i Partisë Socialiste z. Dionis Imeraj ka publikuar në Facebook-un e tij marrëveshjen e arritur ndërmjet bashkisë Dibër dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, për rikonstrukcionin e segmentit rrugor Perlat-Kurbnesh-Krej Lurë-Fushë Lurë. Sipas asaj që ka publikuar z. Dionis Imeraj, marrëveshja e arritur është në kundërshtim me nenin 91, nenin 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, neni 3 “Veprimtari të Ndaluar”, pika 1, “Mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik si dhe ato në funksion të mbrojtjes dhe rruajtjes së mjedisit të shëndetit, të kulturës rinisë, sportive dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe infrastrukturës në shërbim të interesit publik. Referuar këtij vendimi kjo marrëveshje është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, pasi është veprimtari e ndaluar gjatë fushatës zgjedhore”.*

Bashkangjitur denoncimit të kërkuesit janë paraqitur fotografitë e statusit të publikuar në Facebook e z. Dionis Imeraj.

Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk i’a nje shprehimisht Rregullatorit apo Kas-it.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.



Neni 3, paragrafi 2 i vendimit nr. 9/2020, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të Komisionit Rregullator ka përcaktuar rrethin e subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimit të mëposhtëm:

“Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zotëron aksione e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”

Duke qenë se denoncimi lidhet vetëm me kandidatin për deputet z. Dionis Imeraj, theksoj se kandidati për deputet nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

II. Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ më datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në denoncimet e paraqitura me të njëjtin objekt të subjekteve kallëzuese, Partia Demokratike, dega Dibër dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit pretendohet se: “Kandidati për deputet z. Dionis Imeraj ka publikuar në Facebook-un e tij marrëveshjen e arritur ndërmjet bashkisë Dibër dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, neni 3 “Veprimtari të Ndaluar”, pika 1.1, shkronja “b”, “Mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve kombëtare ose vendore,



me karakter social dhe ekonomik si dhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit të shëndetit, të kulturës rinisë, sportive dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe infrastrukturës në shërbim të interesit publik”.

III. Analiza ligjore

Neni 3 pika 1.1, shkronja “b” e vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator parashikon se: “Mbështetja dhe promovimi i projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sportive dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik, përbëjnë veprimtari të ndaluar për t’u promovuar vetëm nëse për të janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve”.

“Veprimtari publike”, në kuptimin e pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe të shkronjës “b” të nenit 2 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë informimin e publikut rreth tyre, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.

Referuar vendimit nr. 4, datë 22.1.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, i cili ka arsyetuar se:

...Postimi në llogarinë e Facebook-ut nuk e bën veprimtarinë publike. Facebook-u apo media të tjera sociale nuk bëjnë pjesë në kategorinë “media” që kërkon paragrafi 1 i nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Dispozita kërkon “pjesëmarrje” të medias, që t’a konsiderojë veprimtarinë publike. Facebook-u nuk ka marrë pjesë në veprimtari sepse Facebook-u nuk është media që “merr pjesë”.

Në rastin konkret, postimi në llogarinë e Facebook të kandidatit për deputet z. Dionis Imeraj nuk e bën veprimtarinë publike.

Veprimtarisë së denoncuar i mungon karakteri publik që kërkon pika 1.1 e nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Karakteri publik është kushti që ndan lejimin nga ndalimi i veprimtarisë.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimeve ndaj kandidatit për deputet z. Dionis Imeraj.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

